

**IEKA****INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË**

Informacion i përditësuar mbi COVID – 19

Rihapja e aktivitetit ekonomik në vendet e rajonit

Shumë vende në Europë po bëhen gati të rinisin aktivitetin e tyre ekonomik, pas mbylljes për më shumë se 2 muaj për shkak të pandemisë së COVID-19. Vende të ndryshme kanë zgjedhur politika të ndryshme për procesin e hapjes:

Shqipëria ka realizuar hapjen bazuar në tre faza:

- Faza I (4 maj): shtimi i zonave të gjelbërta, lejimin e shërbimeve taksi për udhëtimet ndërqytetase etj.
- Faza II (11 maj): hapja e parukerive, klinikave dentare, qendrave tregtare, lëvizje me automjetet pa autorizim nga ora 05:00 – 17:30
- Faza III (18 maj): hapja e bareve, restoranteve dhe zgjatja e fashës orare për lëvizjen e këmbësorëve dhe automjeteve në zonat e kuqe deri në orën 21:00.

Shqipëria por edhe disa vende të tjera ende nuk kanë një datë për hapjen e transportit ajror. Ndërkaq, mesa duket është ende herët të flitet për rihapjen e transportit ajror në Shqipëri, përveç rasteve të riatdhesimeve.

Kosova: Të njëjtën strategji ka ndjekur edhe Kosova ku hapja është bërë me tre faza, veçse me ndryshime në periudhën kur ka ndodhur ky proces. Faza e parë ishin shërbimet që u hapën nga 4 maji, faza e dytë nga 18 maji dhe faza e tretë janë shërbimet që do të hapen më 1 qershor, që është edhe faza e fundit.

Faza I
04 maj 2020

- 3 orë në ditë (sipas shifrës së parafundit të nr. personal – e ndarë në dy pjesë 90 min paradite 90 min pasdite)
- Ndërtimtaria dhe patundshmëria^{1,2,3}
- Tregtia e Automjeteve (pjesërisht)^{1,2,3}
- Tregtia me pakicë (pjesërisht)^{1,2,3}
- Riparimi i artikujve personal dhe i orëdivë^{2,3}
- Zyrat e konsulencës (me lista të staftit esencial)^{2,3}

1 Shitja hapësi e biznesave të reja
2 Shitja e shërbimeve për qytetarët e bizneset
3 Kufizim i rregullave të vendit ose të produkteve epidemologjike

Faza II
18 maj 2020

- Qarkullimi i qytetarëve në bazë të situatës epidemiologjike
- Tregtia me pakicë (plotësisht)^{2,3}
- Dentistët dhe Fizioterapeutët^{2,3,4}
- Flokëtarët dhe Sallonët e ondulimit^{3,4}
- Tregu i gjelbërt^{3,4}
- Gastronomia (merr me vete)^{3,4}
- Transporti Hekurudhor^{3,4}
- Transporti urban dhe ndërrurban (me leje të veçanta)^{3,4}
- Qendrat e thirrjeve (me lista të staftit esencial)^{3,4}
- Hapja e Muzeve dhe Galerive^{2,3}

2 Shitja e shërbimeve për qytetarët e bizneset
3 Kufizim i rregullave të vendit ose të produkteve epidemologjike
4 Në bazë të situatës epidemiologjike

Faza III
fillon me 01 qershor 2020

- Qarkullimi i qytetarëve në bazë të situatës epidemiologjike
- Transporti urban dhe ndërrurban^{3,4}
- Taksitë^{3,4}
- Gastronomia në përgjithësi^{3,4}
- Provimet në Arsimin e Lartë^{3,4}
- Testi i Maturës dhe Arritshmërisë^{3,4}
- Hapja e Kinemave dhe Teatrove^{2,3,4}
- Hapja Selektive e Aktiviteteve Sportive^{3,4}

2 Shitja e shërbimeve për qytetarët e bizneset
3 Kufizim i rregullave të vendit ose të produkteve epidemologjike
4 Në bazë të situatës epidemiologjike



IEKA

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË

Greqia: Faza e parë ka filluar me datë 4 maj, ku u hapën dyqanet e vogla me pakicë, parukeritë, kishat dhe u lejua lëvizja e njerëzve brenda prefekturës së tyre të vendbanimit, por jo jashtë saj. Më 11 maj kanë nisur mësimin nxënësit e vitit të fundit të shkollave të mesme. Qendrat tregtare, kafenetë dhe restorantet do të hapen më 1 qershor, duke ndjekur rregullat e distancimit social.

Mali i Zi: Nga data 4 maj, Mali i Zi ka lejuar të nisin aktivitetin:

- dyqanet e veshjeve, materialeve të ndërtimit, parukeritë, palestrat, libraritë, klinikat dentare, autoshkollat, muzetë dhe galeritë.
- shërbimet e taksisë brenda qytetit
- transporti publik ka nisur në ato qytete ku nuk ka raste të reja të regjistruara me COVID-19.

Në **Maqedoninë e Veriut**, kompanitë e fluturimeve kanë filluar me shitjen e biletave nga destinacionet e Shkupit dhe Ohrit, edhe pse Ministria e Transportit i ka bërë thirrje qytetarëve që të kufizohen në blerjen e biletave për udhëtim jashtë vendit.

Rihapja e turizmit në Europë

Në të gjithë Europën, kombe të ndryshme që aktualisht janë duke lehtësuar masat kufizuese po mundohen të hartojnë një plan për zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2020. Javën e kaluar, Bashkimi European hartoi një plan veprimi për të rihapur kufijtë e saj të brendshëm, për të rifilluar puna në sektorin e tij të turizmit, si dhe të vërë në funksionim lidhjet hekurudhore, rrugore, ajrore dhe detare, të cilat u pezulluan gjatë pandemisë.

BE-ja aktualisht rekomandon të gjitha vendet anëtare që ato të kufizojnë hyrjen e vizitorëve. Por me uljen e niveleve të infeksionit në disa vende, kjo duket se do të ndryshojë. Megjithatë për vizitorët nga jashtë BE ende nuk ka data fikse për rihapjen e kufijve. Për momentin, nëse po planifikoni të udhëtoni në Europë ose brenda Europës në muajt e ardhshëm, ja çfarë duhet të dini:



IEKA

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË

Franca: Deri në datën 24 korrik, kushdo që hyn në vend, me përjashtim të rezidentëve të vendeve anëtare të BE-së do t'i nënshtrohen një karantine të detyrueshme 14-ditore.

Greqia: Aktualisht, të gjithë qytetarët me përjashtim të vendeve anëtare të BE-së, ndalohen të hyjnë në Greqi deri më 31 maj. Hotelet e Greqisë janë planifikuar të rihapen më 1 qershor ndërsa hotelet turistike mendohet të hapen një muaj më vonë.

Spanja: Plazhet e Spanjës janë vendosur të rihapen në qershor dhe hoteleve në disa pjesë të vendit u dha leja për të rifilluar biznesin. Për më tepër, karantina 14-ditore e zbatuar për të gjithë turistët që vijnë në vend nga 15 maji, tani është zgjatuar në 15 qershor, ndërsa kryeministri Pedro Sanchez ka kërkuar zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme të Spanjës deri në fund të qershorit.

Italia: Qeveria italiane ka njoftuar që personat që vijnë nga vendet anëtare të BE-së do të lejohen të hyjnë pa qenë e nevojshme të vetëkarantinohen. Italia ka hapur në datën 4 maj aeroportin Ciampino në Romë dhe aeroportin e Firences, Peretola. Ndërsa në datën 17 maj janë hapur edhe aeroportet e rajonit të Sicilisë dhe Sardenjës.

Gjermania mbetet e mbyllur për turistët jashtë vendeve të BE-së.

Vendimi i qeverisë së **Mbretërisë së Bashkuar** për të vendosur një karantinë 14-ditore për të gjithë ardhjet ndërkohë që filloi të lehtësojë kufizimet për banorët ka humbur çdo shpresë të vazhdueshme për të rifilluar turizmin ndërkombëtar në javët e ardhshme.

Pavarësisht se Kroacia mbështet te sektori i turizmit i cili përbën 20% të PBB të saj, kufizimet aktuale për shtetasit e huaj ka të ngjarë të qëndrojnë në fuqi deri më 15 qershor.

Nga mesi i majit, vendkalimet kufitare të **Zvicrës me Italinë, Francën, Gjermaninë dhe Austrinë**, do të hapen, ne më pak se dy muaj pasi ato ishin mbyllur nga Këshilli Federal për shkak të pandemisë. Aktualisht lejohen të hyjnë në vend vetëm rezidentët dhe ata të cilët udhëtojnë për arsye profesionale.



IEKA

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË

Çekia dhe Sllovakia mendojnë të lejojnë hyrjen në vend vetëm të turistëve të cilët vijnë nga vendet më pak të prekura nga pandemia.


Islanda ka vendosur lehtësimin e kufizimeve ndërkombëtare më datë 15 qershor.

Estonia, Lituania dhe Letonia duke filluar nga data 15 maj kanë lejuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të vendeve të tyre midis këtyre tre vendeve. Ndërkohë individët të cilët vijnë nga vende të tjera, duhet të karantinohen për 14 ditë.

Kryeministri grek njofton rihapjen e kufijve të Greqisë për turistët

Kryeministri grek, Kyriakos Mitsotakis ka njoftuar gjatë një samiti katërpalësh me disa vende të Ballkanit, në kuadër të perspektivave për rimëkëmbjen e rajonit, pas pandemisë së koronavirusit se do të rihapë kufijtë e Greqisë për turizëm më 15 qershor.

Më 1 qershor ai ka miratuar rihapjen e kufijve për udhëtimet e biznesit, punëtorëve sezonalë dhe anëtarëve të familjeve rezidentë në vendet e tjera



20 MAJ 2020



TESTE TË KRYERA

13621



RASTE POZITIVE

964



AKTIVË

175




TË SHËRUAR

758



HUMBJE JETE

31



SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E RASTEVE AKTIVE

TIRANË
DURRËS
KRUJË
SHKODËR
KAMËZ

57

44

33

15

10

BERAT

FIER

ELBASAN

MIRDITË

KORÇË

10

3

1

1

1



**FOR A
GREEN
FUTURE**